

VENDIM
Nr. 5, datë 9.1.2025

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIM MURI RRETHUES PËR GODINËN E RE TË SPAK-ut”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtim muri rrethues për godinën e re të SPAK-ut”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit “truall”, me një vlerë të përgjithshme prej 650 698.80 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 650 698.80 (gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë tetëdhjetë) lekësh, përballohet nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

8. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Veri, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë për Prokurorinë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuar deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë për Prokurorinë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për pasuritë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës,

Drejtoria Vendore Tirana Veri, dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT SHPRONËSOHEN, PËR INTERES PUBLIK, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “NDËRTIM MURI RRETHUES PËR GODINËN E RE TË SPAK-ut”

NR. RENDOR	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE (SIPAS KARTELËS SË PASURISË)										TË DHËNAT PËR SHPRONËSIM			SHËNIME (Kufizime haptësi, barri, etj. sipas pasurisë)
	Emri	Afisja	Mbierimi	Qyteti	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Terra (m ²)	Ndërtesat (m ²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m ²)	Çmimi (€ / m ²)	Vlera (€)	VLERE TOTALE (€)	
1	ATEA	FEJZI	MALAJ	TIRANË	8330	8/436	TRUALL	111	111	0	36	142	6.80	34,068.00	231,662.40	231,662.40	Shënim: Shënim D1 "Lidhur me vendin për vendosje - shënim konstruktiv", me nr. regjistrues 2015, datë 20.03.2022, afat 99 vjet. Zoti Përdhimit Përd "NOTA".
2	REZARTA	AZMI	TELA	TIRANË	8330	8/407	TRUALL	151	151	0	49	246	12.50	34,068.00	419,036.40	419,036.40	
VLERE TOTALE																650,698.80	650,698.80